



FAQJA E PARE SOT

### Kerko ne Korrieri

Submit

### Kerko ne Web

Kerko

Powered by ALBINDEX



**KERKO PER**  
**Kurse në Shqipëri**  
Gjuhe e huaj, Informatike por dhe biznes, robapepsi e me shume. Zgjijdh kursin ne qytetin tend

Zgjijdh



**Numratori Telefonik Shqiptar**

Emri

Mbiemri

Gjej numrin

Powered by [Shqiperia.com](#)

## Gjenden dy anije te mbytura ne 1915

E Hene, 01 Tetor 2007

Rrenojat e dy anijeve italiane te mbytura gjate Luftes se Pare Boterore u zbuluan ne thellesite detare te Gjirit te Vlores. Drejtori i Departamentit te Arkeologjise Nenujore dhe Detare te Institutit Kombetar te Arkeologjise ne Tirane dr.Adrian Anastasi si dhe Presidenti i Shoqerise Nderkombetare te Zhytesve Profesioniste (IANTD), dhane lajmin per kete gjetje te rendesishme arkeologjike. Dy anijet, "Re Umberto" qe transportonte trupa ushtarake dhe anija luftarake "Intrepido", u mbyten ne daten 4 dhjetor te vitit 1915.

Anijet fillimisht u lokalizuan prej Cesare Balzi, instruktori i Agjencise Didaktike IANTD. Me tej te dhenat e sakta historike e shkencore u nxoren ne baze te nje marreveshje bashkepunimi italo-shqiptar me teme "Kerkimi dhe identifikimi i mbetjeve te anijeve te epokes bashkekohore dhe moderne me qellim vleresimin kulturor, turistik dhe nen ujqor te bregdetit Shqiptar", marreveshje e cila eshte firmosur prej Departamentit Arkeologjik Nenujor dhe Detar te Institutit te Arkeologjise ne Tirane dhe te Shoqerise IANTD me baze ne Marina di Piza ne Itali. Projekti eshte drejtuar prej Dr.Adrian Anastasit, i caktuar nga Instituti i Arkeologjise per palen shqiptare si dhe instruktor dhe trajnues Cesare Balzi. Ekspedita per evidentimin e anijeve te mbytura nisi qe prej kater ditesh, ku keto dy dite u filmuan dhe fotografuan pjeset e te dy anijeve te mbytura. Ekspedita pritet te mbaroje te gjithe misionin e saj pas tre ditesh. Sipas nje prej perfaqesuesve te Shoqates se Zhytesve "Ekspedita Blu", qe kryen mbeshtetjen logjistike, Genci Kapllani, u shpreh se Gjiri i Vlores fsheh relike te shumta te anijeve italiane me nje rendesi te vecante historike, te cilat jane fundosur gjate Luftes se Pare dhe te Dyte Boterore, dhe lokalizimi dhe identifikimi i tyre merr rendesi shkencore per te dyja vendet. Sipas dr. Adrian Anastasit, zbulimi i ketyre veprave do te jete nje pasuri nen ujore me vlere te medha per vete qytetin e Vlores. Ne baze te te dhenave historike, duke qene se, pjesa qe prej ishullit te Sazanit dhe deri ne afersi te Vlores, prane Zvernecit ishte minuar me qellim qe forcat gjermane mos te hynin ne gji, forcat e ushtrise italiane kishin lene te hapur vetem ngushticen mes Karaburunit dhe Sazanit e lene per te kaluar mjetet ujore italiane. Anija 'Re Umberto', si pasoje e goditjes me nje mine nga nje anije gjermane rreth ores 10.00 te mengjesit te dates 4 dhjetor te vitit 1915 eshte ndare ne dy pjese, pozicion ne te cilen eshte gjetur dhe sot. Sipas ekipit arkeologjik ne te jane mbytur rreth 60 persona. Pas marrjes se sinjalit per mbytjen e anijes, nga Italia eshte nisur anija tjeter luftarake "Intrepido", e cila ka takuar ne te njejtin minim dhe eshte mbytur rreth ores 17.00. Sipas arkeologeve, ne kete anija jane mbytur 5 marinare te cilet ndodheshin ne anije. Me pas nendetesja gjermane eshte larguar ku sipas dokumenteve historike eshte mbytur pas rreth 3 vjetesh ne Belgjike, si pasoje e nje defekti te brendshem. Sipas ekipit qe u morr me studimin, kane qene te dhenat e mbledhura ne menyre te sakte si dhe studimi i anijeve me perpikmeri, te cilat kane sjelle dhe do te sjellin ne drite te dhena shume te sakta ne lidhje me kohen kur ka ndodhur mbytja, shkaku, personat qe jane mbytur ne te si dhe nje sere faktesh te reja. Ne pamjet e marra prej operatorit italian Massimiliano Cannussa, duken pjeset e anijeve te mbytura, ku ne disa pjese dallohen dhe struktura, pjeset dhe disa detaje te anijes. Anija "Re Umberto" eshte gjetur ne thellesine 50 metra, ndersa anija tjeter "Intrepido" ne thellesine 30 metra. Sipas dr.Adrian Anastasit,

### LAJMET KRYESORE

- Shqiperia, vend islamik
- Frrok Cupi kthehet ne ATSH
- Kercenon me bojkot
- Kujdes ish-ushtaraket dhe Kodin Zgjedhor
- Ndihmoni komunitetin!
- Milo dakort me heqjen e imunitetit
- Ndoka: Jozefina s'na mposht dot
- Reformen e nis nga Kuvendi
- PD
- ben verejtje
- Vjen Pak, per te biseduar shume
- Ne
- pranga "specialistet e antikrimit"
- Grabites i "semure" per "Porche"
- Muaj me bereqet
- Copetojne 400 kg peshkaqen
- Kapet Karamitro i kontrabandes
- Maskat dalin te perdhunojne studentet
- Skenar i zi Hollivudi ne mes te Bllokut
- Broci dhe Budo, gjyqtaret e te miturve
- Mbytet 12-vjecari
- E
- vret depresioni

vazhdimi i kerkimeve ne kete fushe, do te bej te mundur krijimin e nje harte mbi vendndodhjen e anijeve te mbytura pergjate dy lufterave. J.Xhaferi